



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Punijena / Prodato Received / Delivered	28.07.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot B. / Prot Prot No	Shtimi / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKARYSHICK	5442	2023	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.807/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Vjollca Sinani-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.807/2023 të datës 02.06.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.807/2023 të datës 02.06.2023, të parashtruar nga ankuesja
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit të Ankesave për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 02.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4577/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.807/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesën për njohjen e të drejtës së kompensimit të pagës jubilarë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, për shkak të arritjes së përvojës 20 vjeçare të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

08.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 06.07.2023 ka pranuar shkresat lidhur me këtë çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje Kolegji i Këshillit*), me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokolli 4577/2023 të datës 02.06.2023 me shkresat e bashkangjitura; E-maili i dërguar nga V.L drejtuar KPMSHCK e datës 02.06.2023; Shkresë emërimi i lëshuar nga Administrata Shërbimit Korrektues të Kosovës e datës 10.10.2002; E-mail i dërguar nga V.L drejtuar KPMSHCK e datës 13.07.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 08.06.2023; Përgjigja në ankesë e datës 06.07.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 28.02.2023; Konkurs me numër 1332 i datës 15.12.2022; Lista e pagave për periudhën kohore 01.06.2023 deri 30.06.2023; Lista e pagave për periudhën kohore 01.05.2023 deri 31.05.2023; Lista e pagave për periudhën kohore 01.12.2022 deri 31.12.2022; E-mail i dërguar nga M.S drejtuar KPMSHCK e datës 27.07.2023; Ndryshim dhe plotësim i kontratës i datës 20.02.2020; Kontratë pune me numër 224/ QKL/SHKK e datës 07.07.2015.

Kolegji i Këshillit pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Nga administrimi i prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë është konstatuar se ankuesja në bazë të Kontratës së punës për kohë të pacaktuar e datës 28.02.2023 mbanë pozitën "Kuzhinierë" në Qendrën e Paraburgimit Lipjan/ Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 1 dhe 2 përcaktohet se: 1. *Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Zyrtarë publikë janë: 2.1. Nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2 Nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3 Nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4 Nëpunësi administrativ dhe mbështetës*" ndërsa me paragrafin 6 të njëjtit nen përcaktohet se: 6. *Nëpunës administrativo-technik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*" nga rrjedh se pozita e punës "Kuzhinier" sipas përshkrimit të detyrave të punës nuk hynë në kategorinë e pozitave të shërbimit civil, mirëpo por kjo pozitë e punës hynë në kategorinë e pozitave të **Nëpunësve administrativo-technik dhe mbështetës**, dhe për pasojë ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.


Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, si dhe duke marr parasysh faktin se ankuesja e ka statusin e nëpunësit administrativo-technik dhe mbështetës, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për trajtimin e kësaj ankesës, dhe shpall veten jo kompetent për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.807/2023 të datës 02.06.2023 të parashtruar nga ankuesja si në piken 1 të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ku përcaktohet se zyrtarët publik me status të nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente, si dhe në zbatim të nenit 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që lënda t'i bartet për shqyrtim organit kompetent, gjegjësisht Komisionit të Ankesave për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.807/2023**

Vjollca Sinani

Procesmbajtese

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK);
- Komisionit të Ankesave për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës në SHKK;
- Arkivit të KPMSHCK- së.


KOSOVË
2023